

FJALA E DEPUTETIT FLORENC SPAHO

E ENJTE 9 MAJ 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë, 9 maji, Dita e Europës, është shumë e rëndësishme edhe për ne, ndaj sot dua të flas për rininë dhe për Europën, për atë rini që duhet kualifikuar dhe motivuar. Në fakt, dua të falënderoj ministren Kushi, e cila qëndron këtu dhe dëgjon të gjitha problematikat që ngrenë kolegët e opozitës dhe të pozitës, të cilat jam besimplotë se do të gjejnë edhe zgjidhje! Problematika që unë dua të ngre është për fondet që jep Europa për rininë, për programet që ajo ndien për rininë, për ata të rinj që janë pjesë akademike, kërkimore dhe shkencore. Si është gjendja e tyre sot? Sa motivohen ata nga puna e tyre që bëjnë në kërkimin shkencor në universitetet publike dhe private? Sa të rinj dhe stafe akademike kanë përfituar nga fondet e Bashkimit European? Sa studentë të ekselencës dhe stafe akademike të reja kanë përfituar nga projekti “Erasmus” i Bashkimit European. Besoj se janë shumë, por nuk mjafton. Sa kërkime shkencore kanë përfituar dhe kanë bërë të rinjtë e ekselencës për kërkimet shkencore dhe për një program të madh siç është “Horizont 2020” i Bashkimit European? Pse nuk janë në gjendje të gjitha universitetet, përjashtuar disa universitete, ku vlen të përmendet Universiteti Bujqësor apo i Politeknikut, për projekte të cilat dinë t’i bëjnë, i delegojnë, përfitojnë dhe patjetër stafi akademik shkencor i këtij universiteti, po ashtu edhe studentët, janë pjesë? A janë ngritur grupe trajnimi për këto projekte, që të përfitojnë studentët dhe stafet akademike shqiptare të universiteteve të tjera dhe sidomos ato që nuk janë në kryeqytet? Në fakt, Komisioni European publikoi raportin e progresit për Shqipërinë në datën 19.10.2021 dhe nga shqyrtimi vihet re një vlerësim pozitiv në krahasim me raportin e vitit të kaluar.

Ndër të tjera, në fushën e arsimit vlen të theksohet fakti se nivelet e përgatitjes së Shqipërisë në fushën e shkencës dhe kërkimit janë të mira. Progres relativisht i mirë është bërë veçanërisht me aplikimet për projektet në bazë të pjesëmarrjes së Shqipërisë në “Horizont 2020”. Në vitin 2020 kemi pasur 42 aplikues, kurse në vitin 2021 kemi pasur 52 aplikues. Pra, në vitin 2020 kemi përfituar 4,2 milionë euro, kurse në vitin 2021 5,5 milionë euro. Pra, kemi një rritje, por nevojat janë më të mëdha. Me përfundimin e programit “Horizont 2020”, marrjen në konsideratë dhe përmirësimin e Shqipërisë në fushën e kërkimit, pjesëmarrja dhe përfshirja në “Horizont Europë” në programin e ri vjen si domosdoshmëri për të ndërtuar një zonë të përbashkët shkencore dhe teknologjike, për të krijuar një treg të vetëm për kërkimin dhe inovacionin, për të nxitur dhe për të lehtësuar bashkëpunimin midis universiteteve dhe për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe një karrierë tërheqëse kërkimore, për të lehtësuar lëvizshmërinë ndërkufitare dhe ndërsektoriale të studiuesve, për të nxitur lëvizjen e lirë të njohurive shkencore dhe inovacionit, për të promovuar respektimin e lirisë akademike dhe lirisë së kërkimit shkencor, për të mbështetur aktivitete të edukimit shkencor dhe komunikimit, për të inkurajuar konkurrueshmërinë dhe aftësinë tërheqëse të ekonomisë pjesëmarrëse.

Marrëveshja “Horizont Europë” promovon rolin e partneriteteve europiane që adresojnë disa nga sfidat më shtrënguese të Europës, përmes bashkërendimit të nismave të kërkimit dhe inovacionit,

duke kontribuar në mënyrë të konsiderueshme në ato prioritete të Bashkimit European në fushën e kërkimit dhe inovacionit, që kërkojnë masë kritike dhe vizion afatgjatë dhe rëndësinë e përfshirjes në këto partneritete të vendeve të asociuara. Për sa thashë më lart, patjetër që janë bërë hapa, patjetër që kërkohet më shumë dhe patjetër që Agjencisë së Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit i lind si detyrë që duhet të bëjë me zyrat e kërkimit shkencor nëpër universitete, trajnime, ku patjetër që duhen bërë pjesë edhe studentët e ekselencës, që të mësohen që në bankat e shkollës se si bëhet një projekt i cili delegohet në Bashkimin European dhe mund të implementohet nëpër universitete. Në fakt, jam besimplotë që kjo agjenci ka bërë progres dhe do të dijë ta delegojë dhe ta zgjidhë këtë problematikë. Kjo ishte fjala ime për sa u përket kërkimeve shkencore dhe besoj se të gjithë jemi koshientë që kemi shumë nevojë për të thithur fonde nga Bashkimi European. Në fund, si deputet i Komisionit për Edukimin dhe Informimin Publik, dua t'u bëj një thirrje dy institucioneve të nderuara, AMA-s dhe Komisionit kundër Diskriminimit, për një gjuhë aspak korrekte dhe etike që është përdorur në një emision në një televizion privat që bën monologë, ku promovon ndarjen dhe jo bashkimin. Faleminderit!